



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.195/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Adnan Konushevi dhe Afijete Sada – Glogjani, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega në Viti, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK), me seli në Prishtinë dega në Viti, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.195/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Viti subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Viti për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit të kandidatit të tyre, për fushatën zgjedhore në rrugë publike –në Komunën e Vitisë, i shqiptohet gjobë në vlerë prej 2,900.00 (dy mijë e nëntëqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesë me datë 02.10.2019, nga Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se zyrtarët e shtabit zgjedhor të LDK-së në Viti kanë vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me fotografi të printuara. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 02.10.2019, në ora 15:00 zyrtarët e shtabit zgjedhor të LDK-së në Viti kanë hasur në poster të kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), të ngjitura në hapësirat publike, me tutje theksojnë se nga informatat që kanë marr, subjekti politik PDK nuk ka marr pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vendosjen e foto-posterit në rrugë publike.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Partia Demokratike e Kosovës(PDK), ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterin e kandidatit në rrugë publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 03.10.2019, kanë theksuar se shkelja nuk është e qëllimshme, dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore. Në këtë raste Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka ndërmarr masat e duhura për të përmisuar shkeljen e pretenduar sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posteri i kandidati nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografinë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), dega në Viti, është vendosur në hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstatoi se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana Partisë Demokratike të Kosovës(PDK), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), janë vendosur në hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë Partia Demokratike e Kosovës(PDK), në përgjigjen në ankesë i datës 03.10.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti se posterie kandidatit nga ky subjekt politik është vendosur në vende apo hapësira publike. Po ashtu si rrethanë, lehtësuese PZAP-i e mori edhe faktin që subjekti politik në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në uljen e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 195/2019 më datën 05.10.2019.

**Kryesuese e Panelit**  
**Kymete Kicaj**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***